



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 686/2 Prot.

Tiranë, më 26.04.2022

VENDIM

Nr. 43, datë 26.04.2022

PËR
MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE NË RREGULLOREN E VEPRIMTARISË SË
KOMISIONIT TË PROMOVIMIT TË PERSONELIT AKADEMIK TË
UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS

Në zbatim Ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL e RSH", neni 38; pika 1, germa "d", të Statutit të UST-së, neni 20 germa "ë", Senati Akademik i UST-së në mbledhjen e datës 26.04.2022

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimeve në "Rregulloren e veprimtarisë së Komisionit të Promovimit të Personelit Akademik të Universitetit të Sporteve të Tiranës, sipas propozimit të Komisionit të Promovimit të Personelit Akademik të UST (bashkëngjitur këtij vendimi).
2. Ngarkohet Drejtoria Juridike & Zhvillimit të Kurrikulave për të pasqyruar të gjitha ndryshimet në Rregullore.
3. Ngarkohet Drejtoria e Zhvillimit të Programeve dhe Dixhitalizimit të Shërbimeve Akademike-Shkencore për publikimin e këtij Vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK
PROF.DR. AGRON KASA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TE TIRANES

**RREGULLORE E VEPRIMTARISË
SË KOMISIONIT TË PROMOVIMIT TË
PERSONELIT AKADEMIK TË
UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS**

Miratuar me Vendim nr. _____, datë ____/____/2022
Të Senatit Akademik të Universitetit të Sporteve të Tiranës

KREU I TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Objekti

Kjo rregullore synon të përcaktojë rregullat, metodologjinë, procedurat, të drejtat dhe detyrimet e anëtarëve të Komisionit të Promovimit të Personelit Akademik (Komisioni) të Universitetit të Sporteve, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

Neni 2 Qëllimi dhe vlerat udhëheqëse

Komisioni, në ushtrimin e veprimtarisë së tij, ka si qëllim zhvillimin e procesit të promovimit të personelit akademik në përputhje me procedurat, standardet dhe kërkesat e përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore. Në veprimtarinë e tij, komisioni udhëhiqet nga vlerat e: Ligjshmërisë, Transparencës, meritokracisë, objektivitetit, etikës dhe vlerave të akademise.

Neni 3 Baza ligjore

Komisioni, në ushtrimin e veprimtarisë së tij, mbështet në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe Kërkimin shkencor në IAL e Republikës së Shqipërisë”; Ligjit për funksionimin e organeve të administratës shtetërore dhe enteve publike”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.112, datë 23.02.2018 “Për përcaktimin e kritereve për fitimin e gradës shkencore “Doktor” dhe standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademik “Profesor i asociuar” dhe Profesor”, i ndryshuar me VKM nr.808, date 11.12.2019, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.57, datë 29.1.2020 “Për dhënien e statusit të veçantë të Universitetit të Sporteve të Tiranës si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e Sportit në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 4 Standardet për fitimin e titujve akademik dhe aplikimi

Standardet për fitimin e Titujve Akademik; “Profesor i Asociuar” dhe “Profesor”, paraqitja e aplikimeve dhe afatet kohore përkatëse, përcaktohen në Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.112, datë 23.02.2018 “Për përcaktimin e kritereve për fitimin e gradës shkencore “Doktor” dhe standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademik “Profesor i asociuar” dhe Profesor”, i ndryshuar me VKM nr.808, date 11.12.2019, si më poshtë:

Profesor i Asociuar

- a) Aplikimet për fitimin e titullit akademik “Profesor i Asociuar” kryhen nga anëtarët e personelit akademik me kohë të plotë ose të pjesshme, të kategorisë “Lektor”.
- b) Personeli akademik i kategorisë “lektor” aplikon për fitimin e titullit akademik “profesor i asociuar” të paktën 5 (pesë) vjet, nga data që ka mbrojtur gradën shkencore “Doktor”.
- c) Personeli akademik me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme, që aplikon për titullin “Profesor i Asociuar”, duhet:
 - të ketë zhvilluar një cikël të plotë leksionesh për, së paku, një lëndë, për 3 (tri) vite akademike në UST;

- *të ketë përvojë pune si personel akademik me kohë të plotë për një periudhë, së paku, 5-vjeçare (pesëvjeçare), me apo pa ndërprerje ose me kohë të pjesshme si lektor, për një periudhë 8-vjeçare (tetëvjeçare) akademike, me apo pa ndërprerje, pas fitimit të gradës shkencore “Doktor”.*
 - *të jetë i aftë të mbajë leksione në një nga pesë gjuhët e vendeve anëtare të Bashkimit Evropian: angleze, frënge, gjermane, italiane, spanjolle ose të mbrojë veprimtarinë kërkimore botuese përpara Komisionit për Promovimin e Personelit Akademik, në një nga gjuhët e mësipërme, në përputhje me Statutin dhe Rregulloren e UST-së.*
- d) *Personeli akademik, që aplikon për titullin “Profesor i Asociuar”, duhet të shfaqë zotërim të plotë të fushës së tij kërkimore, e cila reflektohet në realizimin e detyrimeve të mëposhtme:*
- *Ka botuar, së paku, 5 (pesë) artikuj shkencorë në revista shkencore brenda vendit ose ndërkombëtare të indeksuara në fushat e studimit dhe kërkimit që aplikohen në UST, ku së paku tre nga to të jenë botuar në Journal of Physical Activity & Sports (The official Journal of Sports University of Tirana) dhe njëra nga to, të jetë cituar e autocituar në revista ndërkombëtare me faktor impakti, të rankuara nga Journal Citation Reports dhe/ose Scopus. Nga këto 5 artikuj e botime, të paktën 2 (dy) prej tyre duhet të jenë botuar në revista ndërkombëtare me faktor impakti, të rankuara nga Journal Citation Reports dhe/ose Scopus dhe që në bibliografinë e të cilave të paktën një nga citimet, përvec autocitimit, duhet të jetë nga autorë të cilët punimin që citohet e kanë botuar në Journal of Physical Activity & Sports (The official Journal of Sports University of Tirana) dhe janë aktualisht punonjës akademikë të UST-së. Kur këta artikuj janë në bashkautorësi, kandidati duhet të jetë autori i parë ose i dytë. Kandidati duhet të jetë autor i vetëm ose i parë në, të paktën, 2 (dy) artikuj shkencorë të paraqitur për fitimin e titullit;*
 - *Ka realizuar si autor i parë, së paku, 5 (pesë) referime në veprimtari shkencore kombëtare apo ndërkombëtare (simpoziun, konferencë, kongres) brenda fushave të studimit apo kërkimit që aplikohen në UST. Nga këto referime së paku, 2 (dy) janë mbajtur në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres) në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-ës, të pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara në “Proceedings”, të indeksuara me kod ISBN ose ISSN dhe të vërtetuara me dokumentacionin përkatës në dosje.*
- e) *Kur kandidati paraqet monografi, e cila përmbush kriteret e mëposhtme, ai mund të lehtësohet nga detyrimet e gjurmës “a”, pika 5 nëpërmjet ekuivalentimit të Monografive sipas gjurmës “b” dhe “c”, të pikës 6., të kreut të II të Vendimitin e Këshillit të Ministrave nr. 112, datë 23.02.2018, i ndryshuar me VKM nr.808, datë 11.12.2019, sipas ekuivalentimit që vijon:*

- *Botimi i 1 (një) monografie shkencore e cila përmban përmbledhje studimesh apo kërkimesh në fushat e studimit apo kërkimit të aplikuara në UST, e botuar pas fitimit të gradës shkencore “Doktor”, brenda ose jashtë vendit, e cila përmbush kushtet e origjinalitetit dhe duhet të jetë vlerësuar në përmbajtje si punim shkencor nga, të paktën, 2 (dy) vlerësues të pavarur të fushës kërkimore-shkencore, dhe të jetë pranuar nga njësia bazë ku kandidati aplikon.*
- *Monografia shkencore e cila përmban përmbledhje studimesh apo kërkimesh në fushat e studimit apo kërkimit të aplikuara në UST, e botuar jashtë vendit konsiderohet e vlefshme vetëm nëse shtëpia botuese është e rankuar nga SENSE Ranking of Academic Publishers, në kategorinë A, B, C ose D. Monografite konsiderohen të ndryshme ndërmjet tyre kur ndryshojnë në përmbajtje me, të paktën, 70%. Monografia e botuar brenda vendit duhet të jetë e vlerësuar në përmbajtje si punim shkencor nga, të paktën, 2 (dy) “profesorë” të fushës kërkimore-shkencore të përzgjedhur nga Komisioni i Promovimit të Personelit Akademik në UST, nga të cilët, të paktën njëri prej tyre duhet të jetë nga vendet anëtare të BE-së, OECD-së ose G20—ës. Ky punim duhet të pranohet nga njësia bazë ku kandidati aplikon nëpërmjet një procesi vlerësues profesional të argumentuar me shkrim për vlerën e shtuar që punimi sjell në procesin akademik të njësisë.*
- **Detyra e shkrimit të monografisë duhet të aprovohet me leje nga njësia bazë ku kandidati aplikon nëpërmjet një procesi vlerësues profesional, të argumentuar me shkrim për vlerën që do të sjellë punimi në fushën e kërkimit shkencor të njësisë bazë të IAL-së.**
- **Miratimi botimit të monografisë vlerohet nga departamenti nëpërmjet një procesi vlerësues profesional të argumentuar me shkrim për vlerën shkencore që përmban kjo monografi dhe ndihmesën që jep në kërkimin shkencor në rang kombëtar e ndërkombëtar.**

Monografia e botuar brenda vendit ekuivalentohet me:

- *2 (dy) artikuj shkencorë, të botuar në revistë shkencore brenda vendit;*
- *1 (një) artikull shkencor, të botuar në revistë shkencore ndërkombëtare me faktor të rankuara nga Journal Citation Reports dhe/ose Scopus.*

Monografia e botuar jashtë vendit ekuivalentohet me:

- *4 (katër) artikuj shkencorë, të botuar në revistë shkencore brenda vendit;*
- *2 (dy) artikuj shkencorë, të botuar në revistë shkencore ndërkombëtare me faktor impakti të rankuara nga Journal Citation Reports dhe/ose Scopus.*

f) *Për efekt të promovimit akademik, merren në konsideratë edhe angazhimet dhe pjesëmarrjet e kandidatit, pas fitimit të gradës shkencore “Doktor”, në:*

- *komitete shkencore apo redaktuese;*
- *veprimtari vlerësuese si anëtar komiteti shkencor apo redaktues për llogari të periodikëve ose joperiodikëve shkencorë;*

- projekte kërkimore-shkencore në nivel drejtuesi, koordinatori ose anëtari;
 - përfitim të financimeve me bazë konkurrimi në nivel kombëtar e ndërkombëtar;
 - projekte të financuara nga programe me donatorë të huaj, të cilat sjellin përfitim për institucionin, në rolin e koordinatorit të projektit;
 - vlerësimet e projekteve kërkimore kombëtare ose ndërkombëtare;
 - si drejtues në komitetet organizuese të konferencave shkencore kombëtare ose ndërkombëtare;
 - projektet e transferimit teknologjik të patentave.
- g) *Angazhimi dhe pjesëmarrja e kandidatit në një ose disa veprimtari të përcaktuara në pikën 7 të kreut të II të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 112, datë 23.02.2018, i ndryshuar me VKM nr.808, datë 11.12.2019, mund të ekuivalentohen nga ana e komisionit me:*
- *1 (një) artikull shkencor, të botuar në revistë shkencore ndërkombëtare me faktor impakti të rankuara nga Journal Citation Reports dhe/ose Scopus.*
 - *1 (një) artikull shkencor, të botuar në revistë shkencore brenda vendit, me bord editorial nga institucione kërkimore shkencore dhe të jene të njohura nga lista e revistave të Ministrisë përgjegjëse për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë dhe 2 (dy) referime mbajtur në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres), në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-ës, të pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara në "Proceedings", të indeksuar me kod ISBN ose ISSN.*
- Këto angazhime dhe pjesëmarrje të kandidatit do të merren në konsideratë për t'u vlerësuar në funksion të promovimit të tij vetëm nëse ato janë brenda fushave të studimit apo kërkimit që aplikohen në UST, të aprovuara për të marrë pjesë aplikanti nga strukturat drejtuese të UST nëpërmjet dokumentacionit përkatës si dhe evidentimit shkresor të kontributit që ka sjellë kjo pjesëmarrje në këtë angazhim dhe të pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor nga ana e Komisionit të Promovimit të Titujve Akademikë në UST, dhe/ose të botuara në "Proceedings", të indeksuara me kod ISBN ose ISSN.***
- h) *Niveli sasior i treguesve, të përcaktuar në pikën 7 të kreut të II të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 112, datë 23.02.2018, i ndryshuar me VKM nr.808, datë 11.12.2019, si dhe vlera përkatëse e tyre parashikohen në rregulloret përkatëse të njësisë bazë e kryesore dhe vendosen në funksion të prioriteteve akademike e strategjike të tyre. Raporti për angazhimin dhe pjesëmarrjen për veprimtaritë e parashikuara në pikën 7 të kreut të II të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 112, datë 23.02.2018, i ndryshuar me VKM nr.808, datë 11.12.2019, hartohet nga njësi bazë e kryesore dhe miratohet nga Komisioni për Promovimin e Personelit Akademik.*

- i) Në rastet kur kandidati ka realizuar studim postdoktoratë në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-ës brenda fushave të studimit dhe kërkimit në UST, me një kohëzgjatje, të paktën, 6 (gjashtë) muaj, shoqëruar me raport të detajuar për aktivitetin kërkimor-shkencor të zhvilluar gjatë kësaj periudhe, ai ekuivalentohet me 1 (një) artikull shkencor të botuar në revistë shkencore ndërkombëtare me faktor impakti dhe 1 (një) referim të mbajtur në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres) në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-ës, të pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara në "Proceedings", të indeksuar me kod ISBN ose ISSN.
- j) Për fitimin e titullit akademik "profesor i asociuar", botimet shkencore të vlefshme janë ato të realizuara pas mbrojtjes së gradës shkencore "doktor", deri në datën e dorëzimit të dosjes së aplikimit për titullin akademik "profesor i asociuar".
- k) Njesitë bazë dhe kryesore të UST-së përcaktojnë në rregulloret e tyre përkatëse kriteret për vlerësimin akademik-didaktik të kandidatëve për fitimin e titullit akademik.

Profesor

- a) Aplikimet për fitimin e titullit akademik "Profesor" kryhen nga anëtarët e personelit akademik me kohë të plotë ose të pjesshme, të cilët mbajnë titullin akademik "Profesor i Asociuar".
- b) Personeli akademik i cili ka titullin akademik "Profesor i Asociuar", aplikon për fitimin e titullit akademik "Profesor", të paktën, 5 (pesë) vite pas fitimit të titullit akademik "Profesor i Asociuar".
- c) Personeli akademik me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme në UST, që aplikon për titullin akademik "profesor", duhet:
- të jetë titullar lënde ose moduli dhe udhëheqës i veprimtarisë shkencore për një periudhë jo më të shkurtër se 5 (pesë) vite akademike ndër të cilat 3 vite në UST;
 - të jetë ose të ketë qenë i punësuar si personel akademik me kohë të plotë si lektor për një periudhë 8-vjeçare (tetëvjeçare) akademike, pas fitimit të gradës shkencore "doktor", ose me kohë të pjesshme, si lektor, për një periudhë 12-vjeçare (dymbëdhjetëvjeçare) akademike pas fitimit të gradës shkencore "doktor";
 - të ketë udhëhequr, të paktën, 2 (dy) doktorata në fushat e studimit dhe kërkimit të aplikuara në UST, **të përfunduara**. Në rast se kandidati ka ushtruar veprimtarinë e tij akademike shkencore pranë një njësie kryesore me më pak se 40 (dyzet) veta personel akademik me kohë të plotë, në momentin e aplikimit të ketë udhëhequr, të paktën, 1 (një) doktoratë të përfunduar;
 - të jetë i aftë të mbajë leksione në një nga pesë gjuhët e Bashkimit Evropian: angleze, frënge, gjermane, italiane, spanjolle ose të mbrojtë

veprimtarinë kërkimore-shkencore përpara Komisionit për Promovimin e Personelit Akademik në një nga këto gjuhë, në përputhje me statutin dhe rregulloren e IAL-së.

- d) *Personeli akademik, i cili aplikon për titullin “profesor”, duhet të shfaqë zotërim të plotë të fushës së tij kërkimore, e cila reflektohet në realizmin e detyrimeve, si më poshtë vijon:*
- e) *Ka botuar, së paku, 7 (shtatë) artikuj shkencorë në revista shkencore brenda vendit ose ndërkombëtare të indeksuara në fushat e studimit dhe kerkimit që aplikohen në UST, ku së paku tre nga to të jenë botuar në Journal of Physical Activity & Sports (The official Journal of Sports University of Tirana) dhe minimalisht njëra nga to, të jete cituar e autocituar në revista ndërkombëtare me faktor impakti, të rankuara nga Journal Citation Reports dhe/ose Scopus. Nga keto 7 artikuj e botime të pakten 3 (tre) prej tyre duhet të jenë botuar në revista ndërkombëtare me faktor impakti, të rankuara nga Journal Citation Reports dhe/ose Scopus dhe që në bibliografinë e të cilave të pakten një nga citimet, përvec autocitimit, duhet të jete nga autore të cilet punimin që citohet e kanë botuar në Journal of Physical Activity & Sports (The official Journal of Sports University of Tirana) dhe janë aktualisht punonjes akademik të UST-se. Kur këta artikuj janë në bashkautorësi, kandidati duhet të jetë autori i parë ose i dytë. Kandidati duhet të jetë autor i vetëm ose i parë në, të paktën 4 (kater) artikuj shkencorë të paraqitur për fitimin e titullit;*
- *Ka realizuar si autor i parë, së paku, 5 (pesë) referime në veprimtari shkencore Kombëtare apo Nderkombetare (simpozium, conference, kongres) Brenda fushave të studimit Apo kerkimit që aplikohen në UST. Nga keto referime së paku 2 (dy) të jenë mbajtur në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres), brenda fushave të studimit dhe kerkimit të aplikuara në UST, në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-ës, të pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara në “Proceedings”, të indeksuar me kod ISBN ose ISSN dhe të vertetuara me dokumentacionin perkates në dosje.*
- f) *Kur kandidati paraqet monografi, e cila përmbush kriteret e mëposhtme, ai mund të lehtësohet nga detyrimet e gërmes përjashtohet nga detyrimet e përcaktuara më lart, sipas ekuivalentimit që vijon:*
- *Botimi i 1 (një) monografie shkencore brenda fushave të studimit dhe kerkimit të aplikuara në UST, e botuar pas fitimit të gradës shkencore “profesor i asociuar” brenda ose jashtë vendit, e cila duhet të përmbushë kushtet e origjinalitetit dhe duhet të jetë vlerësuar në përmbajtje si punim shkencor nga, të paktën, 2 (dy) vlerësues të pavarur të fushës kërkimore-shkencore, dhe të jetë pranuar nga njësi bazë, që mbulon fushën e kerkimit. Monografia shkencore e botuar jashtë vendit konsiderohet e vlefshme nëse shtëpia botuese është e rankuar nga SENSE Ranking of Academic Publishers, në kategorinë A, B, C ose D. Monografite konsiderohen të ndryshme ndërmjet tyre kurndryshojnë në*

përmbajtje me, të paktën, 70%. Monografia e botuar brenda vendit duhet të jetë e vlerësuar në përmbajtje si punim shkencor nga, të paktën, 2 (dy) “profesorë” të fushës kërkimore-shkencore te perzgjedhur nga Komisioni i Promovimit të Personelit Akademik në UST, nga të cilët, të paktën njëri prej tyre duhet të jetë nga vendet anëtare të BE-së, OECD-së ose G20—ës. Ky punim duhet të pranohet nga njësia bazë ku kandidati aplikon nepermjet nje procesi vleresues professional te argumentuar me shkrim per vleren e shtuar qe punimi sjell ne procesin akademik te njesise.

- Detyra e shkrimit të monografisë duhet të aprovohet me leje nga njësia bazë ku kandidati aplikon nepermjet nje procesi vleresues profesional, te argumentuar me shkrim per vleren qe do sjelli punimi në fushën e kërkimit shkencor te njesise bazë të IAL-së.
- Miratimi botimit të monografisë vlersohet nga departamenti nëpërmjet nje procesi vleresues professional te argumentuar me shkrim per vleren shkencore qe përmban kjo monografi dhe ndihmesën që jep në kërkimin shkencor në rang kombëtar e ndërkombëtar.

▪ **Monografia e botuar brenda vendit ekuivalentohet me:**

- 2 (dy) artikuj shkencorë, të botuar në revistë shkencore brenda vendit;
- 1 (një) artikull shkencor, të botuar në revistë shkencore ndërkombëtare me faktor

Monografia e botuar jashtë vendit ekuivalentohet me:

- 4 (katër) artikuj shkencorë, të botuar në revistë shkencore brenda vendit;
- 2 (dy) artikuj shkencorë, të botuar në revistë shkencore ndërkombëtare me faktor impakti të rankuara nga Journal Citation Reports dhe/ose Scopus.

g) Për efekt të promovimit akademik, merret në konsideratë angazhimi dhe pjesëmarrja e kandidatit, pas fitimit të titullit akademik “profesor i asociuar”, në:

- komitete shkencore apo redaktuese;
- veprimtari vlerësuese si anëtar komiteti shkencor apo redaktues, për llogari të periodikëve ose joperiodikëve shkencorë;
- projekte kërkimore-shkencore në nivel drejtuesi, koordinatori ose anëtari;
- përfitimin e financimeve me bazë konkurrimi në nivel kombëtar e ndërkombëtar;
- projekte të financuara nga programe me donatorë të huaj, të cilat sjellin përfitime për institucionin, në rolin e koordinatorit të projektit;
- vlerësimet e projekteve kërkimore kombëtare ose ndërkombëtare;
- si drejtues në komitetet organizuese të konferencave shkencore kombëtare ose ndërkombëtare;
- projektet e transferimit teknologjik të patentave.

h) Angazhimi dhe pjesëmarrja e kandidatit në një ose disa veprimtari të përcaktuara në pikën 6, të kreut të III të Vendimit të Ministrave nr. 112, datë 23.02.2018, i ndryshuar me VKM nr.808, datë 11.12.2019, mund të ekuivalentohet me:

- 1 (një) artikull shkencor, të botuar në revistë shkencore ndërkombëtare me faktor impakti të rankuara nga Journal Citation Reports dhe/ose Scopus.
- 1 (një) artikull shkencor, të botuar në revistë shkencore brenda vendit, me bord editorial nga institucione kerkimore shkencore dhe të jete të njohura nga lista e revistave të Ministrisë përgjegjëse për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë, dhe 2 (dy) referime të mbajtura në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres) në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-ës, të pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara në "Proceedings", të indeksuar me kod ISBN ose ISSN.

Këto angazhime dhe pjesëmarrje të kandidatit do të merren në konsideratë për t'u vlerësuar në funksion të promovimit të tij vetëm nëse ato janë brenda fushave të studimit apo kërkimit që aplikohen në UST, të aprovuara për të marrë pjesë aplikanti nga strukturat drejtuese të UST nëpërmjet dokumentacionit përkatës si dhe evidentimit shkresor të kontributit që ka sjellë kjo pjesëmarrje në këtë angazhim dhe të pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor nga ana e Komisionit të Promovimit të Titujve Akademikë në UST, dhe/ose të botuara në "Proceedings", të indeksuar me kod ISBN ose ISSN.

- i) Niveli sasior i treguesve të përcaktuar në pikën 6, të kreut të III të Vendimit të Ministrave nr. 112, datë 23.02.2018, i ndryshuar me VKM nr.808, datë 11.12.2019, si dhe vlera përkatëse e tyre parashikohen në rregulloren përkatëse të njesise baze e kryesore të UST-se dhe vendosen në funksion të prioriteteve akademike e strategjike të tyre. Raporti për angazhimin dhe pjesëmarrjen për veprimtaritë e parashikuara në pikën 6, të kreut të III të Vendimit të Ministrave nr. 112, datë 23.02.2018, i ndryshuar me VKM nr.808, datë 11.12.2019, hartohet nga njësite bazë dhe njësite kryesore dhe miratohet nga Komisioni për Promovimin e Personelit Akademik.
- j) Për fitimin e titullit akademik "profesor", botimet shkencore të vlefshme janë ato të realizuara pas mbrojtjes së titullit akademik "profesor i asociuar" deri në datën e dorëzimit të dosjes së aplikimit për titullin akademik "profesor".
- k) Njesia baze dhe kryesore në rregulloret e tyre përkatëse, përcaktojnë kriteret për vlerësimin akademiko-didaktik të kandidatëve për fitimin e titujve akademikë.
- l. Angazhimi dhe pjesëmarrja e aplikantit në veprimtaritë e parashikuara në pikën 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 112, datë 23.02.2018, i ndryshuar me VKM

nr.808, date 11.12.2019 mund të ekuivalentohet në një botim me faktor impakti, referuar pikës 8 të VKM-së nr.112, datë 23.02.2018.

Neni 5

Fusha e veprimit të rregullores

Kjo rregullore zbatohet nga Komisioni për të gjitha aplikimet e bëra nga hyrja në fuqi e ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe Kërkimin shkencor në IAL e Republikës së Shqipërisë” dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.112, datë 23.02.2018 “Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore “Doktor” dhe standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademik “Profesor i ascuar” dhe Profesor”, i ndryshuar me VKM nr.808, date 11.12.2019 .

KREU II

KOMISIONI PËR PROMOVIMIN E PERSONELIT AKADEMIK DHE JURIA PËRBËRIA, FUNKSIONET DHE PËRGJEGJËSITË

Neni 6

Përbërja e Komisionit

Komisioni për promovimin e personelit akademik, në vijim “Komisioni”, përbëhet nga 7 (shtatë) anëtar. Anëtarët e Komisionit duhet të kenë/mbajnë titullin akademik Profesor. Anëtarët e Komisionit vetëkandidohen dhe zgjidhen anëtar nga Senati Akademik. Anëtarët e Komisionit kanë mandate dy-vjeçar dhe me të drejtë rizgjedhje.

Neni 7

Funksionet dhe detyrat e Komisionit

1. Komisioni funksionon si organ kolegjal, vendimmarrës dhe është përgjegjës për promovimin e Personelit Akademik të UST-së.
2. Shqyrton dhe vlerëson dokumentacionin e aplikantëve për titujt akademik sipas kriterëve dhe kërkesave të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.
3. Organizon, miraton dhe mbikëqyr procedurën e ngritjes dhe funksionimit të Jurisë.
4. Për ngritjen e Jurisë së vlerësimit të dokumentacionit të aplikantit, Komisioni përzgjedh 5 anëtar ndër 8 propozimet e paraqitura nga drejtuesi i njësisë kryesore dhe të miratuara nga Rektori i UST-së.
5. Zgjedh Kryetarin e Jurisë. Si rregull, Kryetar i Jurisë zgjidhet anëtari më me përvojë (i vjetër) i jurisë.
6. Anëtarët e jurisë, përzgjidhen sipas fushës së aktivitetit të aplikantit. Tre prej pjesëtarëve të Jurisë mbulojnë fushën e gjerë të aktivitetit dhe Dy të tjerë, fushën e aplikuar.
7. Juria përbëhet nga 5 anëtare nga të cilët të pakten 2 anëtarë janë nga jashtë IAL-së.
8. Në përfundim të vlerësimit të aktivitetit të aplikantit, Juria harton Raportin Vlerësues, ku shprehet qartë për miratimin ose refuzimin e kërkesës së aplikantit për fitimin e titullit akademik.
9. Raporti Vlerësues duhet të jetë i argumentuar dhe vlerësues për çdo aspekt/tregues vlerësimi të aktivitetit të aplikantit.
10. Kur anëtari/ët e jurisë kanë vlerësim të ndryshme nga pjesa tjetër e Jurisë, hartojnë një raport të veçantë dhe ja bashkëlidhin raportit të jurisë.

11. Raporti i vlerësimit të Jurisë, duhet të firmoset në çdo faqe nga të gjithë anëtarët e Jurisë dhe i dërgohet Komisionit të Promovimit të Personelit Akademik.

Neni 8

Detyrat dhe të drejtat e anëtarit të Komisionit

1. Të sigurojë pjesëmarrjen në çdo mbledhje dhe të jetë proaktiv në çështjet dhe tematikat që janë brenda objektivit të veprimtarisë së Komisionit.
2. Të shprehë qëndrimin, vlerësimin dhe vendimin e tij lidhur me çështjet që trajton Komisioni.
3. Të propozojë dhe miratojë tematikën/rendin e ditës së mbledhjeve të Komisionit
4. Të vetë deklarojë në çdo rast situatat e mundshme të konfliktit të interesit për veten e tij dhe të kërkojë verifikimin e konfliktit të interesit për secilin prej anëtarëve të Komisionit.
5. Të zbatojë afatet kohore të realizimit të detyrave dhe procedurave në Ushtrimin e veprimtarisë së tij si anëtar i Komisionit.

Neni 9

Ndërprerja e mandatit të anëtarit të Komisionit dhe zëvendësimi i tij

1. Anëtari i Komisionit e humbet mandatin kur për dy herë radhazi nuk merr pjesë në mbledhjet e Komisionit.
2. Anëtari i komisionit zëvendësohet me kandidatin e radhës të rezultuar, listuar nga procesi zgjedhor i Senatit.

Neni 10

Kryetari i Komisionit. Të drejtat dhe detyrat.

1. Kryetari i Komisionit të Promovimit të Personelit Akademik, zgjidhet me shumicën e votave të anëtarëve të Senatit Akademik.
2. Kryetari i Komisionit organizon dhe drejton mbledhjet e Komisionit. Njofton anëtarët e Komisionit për datën, orën, rendin e ditës dhe vendin e zhvillimit të mbledhjeve. Drejton diskutimet dhe siguron të drejtën e anëtarëve për diskutime. Koordinon, mbështet dhe siguron që veprimtaria e Komisionit dhe vendimmarrja janë në përputhje me kuadrin normativ ligjor e nënligjor në fuqi.
3. Me miratimin e Komisionit ngre grupe punë për shqyrtimin e e tematikave dhe çështjeve që lidhen me objektin e veprimtarisë së Komisionit.
4. Krijon dhe administron dokumentimin e mbledhjeve të Komisionit. Në bashkëpunim me Rektoratin e IAL-se siguron logjistikën e nevojshme për zhvillimin e mbledhjeve të Komisionit.
5. Përfaqëson Komisionin në marrëdhëniet me të interesuarit dhe me të tretët.

Neni 11

Ngritja e Jurisë

1. Komisioni, për rastet kur dokumentacionin e aplikantit e ka vlerësuar të plotë, fillon procedurën e ngritjes së Jurisë. Për ngritjen e Jurisë, Kryetari i kërkon Titullarit të IAL-se, paraqitjen e jo më pak se 8 emrave të kandidatëve për anëtar Jurie.
2. Paraqitja e kandidaturave për anëtar Jurie, depozitohen nga IAL në Komision Brenda 3 (tre) ditëve pune nga marrja në dorëzim e kërkesës së Komisionit.

3. Komisioni, brenda 3 (tre) ditëve punë, në mbledhjen e radhës, me votim përzgjedh dhe miraton Jurinë.
4. Zëvendësimi i anëtarit të Jurisë, për shkaqe të konfliktit të interesit dhe/ose shkaqe të tjera objektive e të ligjshme, bëhet nga lista e miratuar në Komision pas procedurës së votimit.

Neni 12

Konflikti i interesit dhe çështjet e etikës

1. Zëvendësimi i Anëtarit të Komisionit dhe anëtarit të Jurisë, për shkaqe të konfliktit të interesit dhe/ose shkaqe të tjera objektive e të ligjshme, bëhet nga lista e miratuar në Komision pas procedurës së votimit.
2. Anëtarët e Komisionit dhe të Jurisë, janë përgjegjës për ruajtjen e konfidencialitetit dhe përdorimit të të dhënave që janë rezultat i veprimtarisë së vlerësimit të aktivitetit të aplikantit.

KREU III

PRANIMI DHE SHQYRTIMI I DOKUMENTACIONIT

Neni 13

Afatet kohore dhe shqyrtimi

2. Afati kohor për fillimin e shqyrtimit nga Komisioni, fillon në datën e marrjes në dorëzim të dokumentacionit në KPPA.
3. Dokumentacioni i aplikantëve shqyrtohet sipas radhës së pranimit të aplikimit në Komision.
4. Komisioni pas shqyrtimit të dokumentacionit të aplikantit dhe analizës së Vendimit të Departamentit shprehet me Vendim për përmbushjen ose jo të kërkesave dhe standardeve nga aplikanti. Komisioni, në shqyrtimin e përmbushjes ose jo të kërkesave dhe standardeve akademike të dosjes së aplikantit bazohet në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 112, datë 23.02.2018, i ndryshuar me VKM nr.808, date 11.12.2019.
5. Në rastet kur dokumentacioni i aplikantit është i plotë, Komisioni përzgjedh jurine dhe vendos përcjelljen e dosjes aplikantit në Juri.
6. Kur Komisioni konstaton se dokumentacioni i aplikantit është jo i plotë, ndiqen procedurat e parashikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 112, datë 23.02.2018, i ndryshuar me VKM nr.808, date 11.12.2019.

KREU IV

ORGANIZIMI I MBLEDHJEVE TË KOMISIONIT

Neni 14

Mbledhja e komisionit

1. Organizohet nga kryetari, si dhe nga vetë komisioni, më kërkesë të dy anëtarëve.

2. Mbledhja e Komisionit zhvillohen kur janë të pranishëm jo më pak se 2/3 e anëtarëve. Kur në hapjen e mbledhjes nuk plotësohet ky Quorum, mbledhja organizohet një ditë tjetër.
3. Lajmërimi/njoftimi për organizimin e mbledhjeve bëhet të paktën 3 (tre) ditë para ditës së mbledhjes. Njoftimi i anëtarëve bëhet me postën elektronike dhe me telefon nga struktura mbështetëse e Komisionit.
4. Njoftimi i anëtarit/ve të Komisionit përmes postës elektronike, krahas datës, vendit dhe orës së zhvillimit të mbledhjes, shoqërohet edhe me tematikën e Rendit të Ditës, si dhe çdo dokument tjetër të arsyetuar nga Kryetari I Komisionit.
5. Çdo ndryshim që i përket organizimit dhe zhvillimit të mbledhjes i njoftohet anëtarëve të paktën 48 orë para datës së mbledhjes.

Neni 15

Struktura ndihmëse e Komisionit

1. Në veprimtarinë e tij Komisioni mbështetet nga struktura ndihmëse, në vijim "Sekretaria". Sekretaria përbëhet nga një punonjës të IAL-se që kryen veprimtari administrative.
2. Sekretaria teknike mbulohet nga sekretaria e rektoratit dhe është në varësi të Kryetarit të Komisionit në kryerjen e kesaj detyre suplementare.
3. Sekretaria pranon kërkesat dhe dokumentacionin e dosjeve të kandidatëve dhe bën listimin e aplikimeve dhe dokumenteve të paraqitur dhe harton një relacion me shkrim për Kryetarin e Komisionit.

Sekretaria e Komisionit, sipas udhëzimeve të Kryetarit, përgatit;

- Mbledhjen e Komisionit
- Njofton anëtarët për mbledhjen, datën, orën, vendin dhe rendin e ditës.
- Mban proces verbalin e mbledhjes së komisionit në librin përkatës të mbledhjeve.
- Në përfundim të çdo mbledhjeje, kërkon dhe administron nënshkrimin e proces verablit dhe të vendimeve nga të gjithë anëtarët e pranishëm në mbledhje.
- Me miratim të kryetarit, dorëzon në zyrën/strukturën e arkiv protokollit të Universitetit të gjithë dokumentacionin e krijuar/ objekt të veprimtarisë së Komisionit.

Neni 16

Marrja e vendimeve dhe proces verbali

1. Komisioni merr vendime për çështjet e rendit të ditës ose për çështje shtesë, të miratuara paraprakisht.
2. Komisioni, me votim të hapur dhe me shumicën absolute të votave të anëtarëve, merr vendim për dhënien e titullit "Profesor" dhe "Profesor i Asociuar".
3. Në rastet kur numri i votave është i barabartë, vota e kryetarit të Komisionit përcakton rezultatin dhe shprehet në vendim.
4. Në çdo mbledhje të Komisionit mbahet proces verbali përkatës.
5. Në proces verbal, pasqyrohet, pjesëmarrja e anëtarëve dhe diskutimet e secilit anëtar lidhur me tematikat e rendit të ditës. Në proces verbal pasqyrohet çdo mendim, koment dhe sugjerim që kërkohet nga anëtari/ët e Komisionit.

6. Në përfundim të çdo mbledhje, Proces verbali nënshkruhet nga anëtarët e pjesëmarrës në mbledhje

KREU V E DREJTA E ANKIMIMIT

Neni 17 Ankimi

1. Çdo aplikant gëzon të drejtën e ankimit ndaj vendimeve të ndërmjetme të Komisionit të Promovimit të Personelit Akademik, në lidhje me zbatimin e procedurave të ndjekura nga Komisioni, deri para miratimit të vendimit përfundimtar të Komisionit.
2. Vendimet e konkludura pas shqyrtimit të ankimit, janë të formës së prerë dhe përfundimtare për Komisionin dhe i njoftohen ankimuesit përmes Kryetarit.
3. Në rastet kur vendimi i komisionit është refuzues për fitimin e titullit akademik, kandidati ka të drejtën e riaplikimit sipas afateve dhe kërkesave të përcaktuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 112, datë 23.02.2018, i ndryshuar me VKM nr.808, date 11.12.2019.

KREU VI HYRJA NË FUQI, ZBATIMI DHE NDRYSHIMI I RREGULLORES

Neni 18 Miratimi, interpretimi dhe ndryshimet e rregullores

1. Kjo rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga Komisioni dhe Senati Akademik i UST-së.
2. Të drejtën e interpretimit të Rregullores e ka Komisioni.
3. Për ndryshimin e Rregullores së Komisionit, kanë të drejtë të propozojnë: Rektorati, Njësitë Kryesore dhe ato Bazë të UST-së si dhe çdo anëtar i Komisionit.
4. Të drejtën e ndryshimit të kësaj Rregulloreje, e ka vetëm Komisioni. Çdo ndryshim i rregullores, hyn në fuqi dhe bëhet pjesë e Rregullores, pas miratimit në Senatin Akademik.

Neni 19 Hyrja në fuqi

1. Kjo Rregullore hyn në fuqi menjëherë.

Prof.Dr. AGRON KASA
Kryetari i Senatit Akademik të UST

